

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6307
E enje, 6 maj 2021
çmimi 0.40 €

Odat ekonomike
kërkojnë ndryshimin e
Ligjit për Festat
Zyrtare! FAQE 9



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA INJORUAR KËRKESAT PËR SHKARKIM
TË MINISTRES DONIKA GËRVALLA FAQE 4-5

OPOZITA I KËRKON KURTIT TA MBROJË UÇK-në DHE TA SHKARKOJË GËRVALLËN



Subjektet opozitare i kanë kërkuar kryeministrin Albin Kurti që ta mbrojë UÇK-në e jo zëvendësen e tij, ministren e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Donika Gërvalla. Pasi kryeministri i ka dalë në

mbrojtje kryediplomates Gërvalla, e cila ka thënë se do të bashkëpunojë me Specialen kundër ish-krerëve të UÇK-së, opozita e ka kritikuar Kurtin, duke thënë se ka nisur luftën speciale të

propagandës kundër UÇK-së. Zyrtarët opozitarë ia kanë kujtuar Kurtit deklaratat e tij sa ishte në opozitë, i cili thoshte se shteti duhet ta organizojë mbrojtjen e ish-krerëve të UÇK-së në Hagë

OLIVER VARHELYI: PANDEMIA PËRFUNDON PASI TË VAKSINOHEMI TË GJITHË FAQE 3



KOSOVA PO MERR PËRSË NË STËRVITJET E NATO-S ME 330 USHTARË FAQE 3



DEKLARATAT SKANDALOZE
TË MINISTRES SË PUNËVE
TË JASHTME DHE PASOJAT
DIPLOMATIKE E JURIDIKE
PËR KOSOVËN! F. 10



Shkruan:
Dr. sc. Ferat SHALA

AKTUALE

FILLON MËSIMI PLOTËSUES PËR
NXËNËSIT QË KANË NGECJE NË
ARRITJEN E REZULTATEVE F. 7

MILLANOVIQI: NUK MUND TË
OFROJ GARANCI PËR THAÇIN F. 5




EKONOMI

KOSOVA, BURIMI KRYESOR
I TURISTËVE NË SHQIPËRI F. 9

ATK-ja: TATIMPAGUESIT
T'U PËRGJIGJEN DETYRIMEVE
TATIMORE F. 9

SPORT

VDES AKTORI SHQIPTAR
GULJELM RADOJA F. 12



RENOVA
PUTZ FAQE 3
Makedoni Xhepcisht-Tetovë Curë-Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
088 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVO
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Bideni synon ta zgjerojë fushatën e vaksinimit për adolescentët

UASHINGTON, 5 MAJ - Presidenti amerikan Joe Biden ka bërë me dije planet për t'u vaksinuar kundër koronavirusit 70 për qind të të rriturave amerikane deri më 4 korrik. Sipas tij, vaksinimi i të rinxje të moshave 12-15 vjeç do të nisë sa më shpejt që është e mundur. Synimi i rri Bidenit përfshin vaksinimin e plotë të 160 milionë amerikanëve deri në Ditën e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara.

Ky plan është bërë me dije

ndërkohë që 103 milionë amerikanë veçse janë vaksinuar kundër Covid-19, sëmundjes që shkakton koronavirusi. Autoritetet amerikane janë duke vaksinuar aktualisht rrëth 1 milion të rritur në ditë. Biden ka thënë se administrata e tij është duke punuar për të fituar kundër "dyshuesve" të vaksinave. "Në dy muaj, le ta festojmë pavarësinë e kombit dhe pavarësinë nga virusi. Ne mund ta bëjmë këtë. Ne do ta bëjmë

këtë", ka thënë Bideni të hënën nga Shtëpia e Bardhë. Presidenti demokrat ka paraqitur edhe një faqe të re online, vaccines.gov, të cilën mund ta shfrytëzojnë amerikanët për t'i gjetur më lehtë qendrat e vaksinimit, pas ankesave se procesi i regjistrimit ka qenë shumë i vështirë për disa persona. Bideni ka thënë se synimi i tij është që jeta t'i kthehet normalitetit nga 4 korriku.



Trumpi prezanton blogun e tij



Uashington, 5 maj - Ish-presidenti amerikan Donald Trump ka krijuar një hapësirë në faqen e tij online ku do të mund të publikojë komente. Ai ka marrë këtë hap para vendimit të gjigantit "Facebook", i cili do të vendosë nëse do ta vazhdojë bllokimin e llogarisë së Trumpit në këtë platformë. Trump ka prezantuar blogun e ri, që u mundëson të tjerëve t'i shpërndajnë mesazhet në "Facebook" dhe "Twitter". Trump nuk ka arritur së fundmi te secili ndjekës i tij pasi "Facebook"-u ia ka pezulluar llogarinë më 7 janar për shkak të komenteve që, sipas udhëheqësve të rrjeteve sociale, kanë nxitur dhunë, që

më pas ka rezultuar me trazira vdekjeprurëse në Kongresin amerikan. Vendimi për ta rishikuar vendimin nëse duhet vazhduar pezullimin e llogarisë do të varet nga "Facebook" dhe i njëjti nuk mund të apelohet. Ky vendim është duke u shikuar me vëmendje nga politikanët, ekspertët përliri të mediave dhe aktivistë nga e gjithë bota, meqë për disa ky vendim mund të krijojë precedent. Për dallim nga "Facebook", platforma tjetër "Twitter", e preferuara e Trumpit, ia ka bllokuar atij përgjithmonë qasjen për shkak të situatës që më pas ka shpërthyer në Kongres më 6 janar.

Gjermania ndalon një organizatë islamike

BERLIN, 5 MAJ - Gjermania ndaloi të mërkurën organizatën islamike Ansaar International për të cilën tha se ka mbledhur fonde për të ndihmuar në financimin e terrorizmit në botë. Vendimi u mor pasi autoritetet bastisën prona në dhjetë lande gjermane dhe sekuestruan disa gjësende. "Nëse doni të luftoni terrorin, duhet t'ia shteroni

fondet e financimit", ka thënë ministri i Brendshëm i Gjermanisë, Horst Seehofer. Organizata Ansaar, me seli në qytetin Dyzeldorf, thotë në statutet e saj se qëllimi i saj është t'i mbështesë projektet përmyslimanët në të gjithë botën. Sipas kryetarit të saj, Ansaar, vetëm në vitin 2018 ka mbledhur dhjetë milionë euro donacione.

Ministria e Brendshme e Gjermanisë tha se fondet kanë për qëllim financimin e grupeve të huaja, të tilla si lëvizja palestinezë Hamas, pastaj Al-Shababi i lidhur me Al-Kaidën dhe Al-Nusra. Ansaar dhe një organizatë e lidhur me të "financojnë terrorin në të gjithë botën, nën maskën e ndihmës humanitare", tha Seehofer.



Vdes aktori shqiptar Guljelm Radoja



TIRANË, 5 MAJ - Aktori shqiptar Guljelm Radoja ka vdekur nga koronavirusi në moshën 75 vjeç. Autoritetet shëndetësore kanë njoftuar dy ditë më parë se ai ka qenë në intubim. Ai është trajtuar nga Covid-19 për gati një muaj. Guljelm Radoja ka lindur më 2 korrik të vitit 1945 në qytetin e Shkodrës. Ndër interpretimet e tij në teatër përmendet për rolet në

dramat "Bourgeois Wedding" e Bertold Brehtit, "Me syrin e një klouni" e Heinrich Bellit, "Trojanët" e Vasilis Theodoropoulosit e tjera. Në kinematografi ai ka luajtur më shumë se 30 role. Rol i tij i parë ishte ai i inxhinierit të pyjeve në filmin "Gjurma" në vitin 1970. Ai më pas ka luajtur edhe një varg rolesh të tjera si ai i Tenente Gruabardhit në filmin "Në fillim

të verës" në vitin 1975, roli i Stefan Bardhit në filmin "Mësonjëtorja" në vitin 1979, roli i Petro Nini Luarasit në filmin "Kush vdes në këmbë" në vitin 1984, roli i priftit në filmin "Kthimi i ushtrisë së vdekur" në vitin 1989, roli i prokurorit në filmin "Kolonel Bunker" në vitin 1998 e të tjera. Për meritat e tij artistike Guljelm Radoja është nderuar me titullin "Artist i Merituar".

Oliver Varhelyi: Pandemja përfundon pasi të vaksinohemi të gjithë

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me komisionarin e lartë të Bashkimit Evropian për Zgjerim dhe Fqinjësi, Oliver Varhelyi, kanë parë të mërkurën nga afër procesin e vaksinimit kundër Covid-19 të stafit shëndetësor në Kosovë. Varhelyi ka thënë se dërgesa e 4 majit është e para në mesin e 95 000 dozave që BE-ja i ka ndarë për Kosovën. Sipas tij, dërgesa e radhës do të arrijë në Kosovë në muajin qershor



EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me komisionarin e lartë të Bashkimit Evropian për Zgjerim dhe Fqinjësi, Oliver Varhelyi, kanë parë nga afër procesin e vaksinimit kundër Covid-19 të stafit shëndetësor në Kosovë. Komisionari Varhelyi ka thënë se është i lumtur që sheh njerëzit duke u vaksinuar. "Ditë e mrekullueshme për Kosovën. Ka qenë detyrë e rëndë për të siguruar vaksina, por ja ku janë", ka thënë ai. Varhelyi ka thënë se dërgesa e 4 majit është e para në mesin e 95 000 dozave që Bashkimi Evropian i ka ndarë për Kosovën në kuadër të mbështetjes së vaksinimit në vendet e Ballkanit Perëndimor. Sipas tij, dërgesa e radhës do të arrijë në Kosovë në muajin qershor dhe me këto doza do të mund të vaksinohet i gjithë stafi shëndetësor. "Pandemja do të përfundojë vetëm pasi të gjithë të jemi vaksinuar", ka thënë mes tjerash ai. Kurti, ndërkaq, ka thënë se

Qeveria e Kosovës është duke punuar në vazhdimësi për sigurim të më shumë vaksinave kundër këtij virusi. "Sot po e rifillojmë procesin e vaksinimit me qëllim që të mos ndalemi dhe të vazhdojmë derisa ta arrijmë objektivin tonë për vaksinimin e 60 për qind të

popullsisë. Ne synojmë që t'i vaksinojmë grupet e rezikuara para verës dhe të vazhdojmë me pjesën tjeter të përputhje me planin shtetëror të vaksinimit kundër Covid-19", ka thënë Kurti të mërkurën nga salla "1 Tetori", ku ka rinisur procesi i imunizimit, pas pranimit

të 4 680 vaksinave të kompanisë "Pfizer/BioNTech" më 4 maj. Kosova ka nisur procesin e vaksinimit në fund të muajit mars, me 24 000 doza të vaksinës "AstraZeneca", të siguruara nga programi Covax i Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Kosova po merr pjesë në stërvitjet e NATO-s me 330 ushtarë



PRISHTINË, 5 MAJ - Kosova po merr pjesë në stërvitjen ushtarake të NATO-s "Defender Europe 21" me 330 pjesëtarë, tha ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Armend Mehaj. "Pjesëmarra jonë në

'Defender Europe 21' është 330 pjesëtarë dhe do të jetë një validim i kompanisë tonë. Kështu që, ne jemi pjesëmarrës në 'Defender Europe 21' dhe është kënaqësi të jemi aty", ka

deklaruar Mehaj të mërkurën, teksha ka raportuar para Komisionit Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Më 29 prill në Shqipëri NATO nisi stërvitjen "Defender

Europe 21", që është stërvitja me shkallën më të gjerë që është mbajtur në Ballkanin Perëndimor që nga Lufta e Dytë Botërore. Në këtë stërvitje po marrin pjesë mijëra forca nga Shtetet e

Bashkuara. Ato do të mbajnë stërvitje në gjashtë baza tokësore, detare dhe ajrore në Shqipëri deri më 10 qershor. Duke folur për operacionet jashtë vendit, ministri Mehaj tha se ato validojnë rrugën e Kosovës drejt aleancës së NATO-s. Ai ka paralajmëruar se shumë shpejt pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës do të marrin pjesë edhe në operacione të tjera. "Sa iu përket çështjeve operacionale jashtë vendit, kjo ka domethëniet të madhe në rrugëtimin tonë drejt NATO-s. Së pari është Kuvajti, por jemi duke punuar edhe në drejtime të tjera. Do t'ju raportoj njëkohësisht. Kështu që shumë shpejt do të marrim pjesë edhe në operacione të tjera jashtë vendit", ka thënë Mehaj.

Në mars një kontingjent i FSK-së u nis për në Kuvajt, që është misioni i parë jashtë vendit i kësaj force. Vendimi për dërgimin e kontingjentit të FSK-së në misionin e parë jashtë vendit ishte marrë më 31 dhjetor 2020. Më 2018 përmes ndryshimeve ligjore ka nisur transformimi i mandatit të FSK-së në forca të armatosura. Ky proces pritet të zgjasë dhjetë vjet.



KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA INJORUAR KËRKESAT PËR SHKARKIM TË MINISTRES DONIKA GËRVALLA

Opozita i kërkon Kurtit ta mbrojë UÇK-në dhe ta shkarkojë Gërvallën

Subjektet opositare i kanë kërkuar kryeministrit Albin Kurti që ta mbrojë UÇK-në e jo zëvendësen e tij, ministren e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Donika Gërvalla. Pasi kryeministri i ka dalë në mbrojtje kryediplomates Gërvalla, e cila ka thënë se do të bashkëpunojë me Specialen kundër ish-krerëve të UÇK-së, opozita ka kritikuar Kurtin, duke thënë se ka nisur luftën speciale të propagandës kundër UÇK-së. Zyrtarët opositorë ia kanë kujtuar Kurtit deklaratat e tij sa ishte në opozitë, i cili thoshte se shteti duhet ta organizojë mbrojtjen e ish-krerëve të UÇK-së në Hagë

**EPOKA
ERE**

Muhamed KOCI

PRISHTINË, 5 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka dalë në mbrojtje zëvendëses së tij dhe ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, e cila kohë më parë ka thënë se do të bashkëpunojë me Gjykatën Speciale kundër ish-krerëve të UÇK-së. Ai ka thënë se Gërvalla e afiron luftës e UÇK-së, duke shtuar se reagimet ndaj deklaratave të saj janë fushatë. "Dje duket se filloj një fushatë kundër zëvendëses

sime dhe ministres së MPJD-së, znj. Donika Gërvalla, me tezën se ajo nuk e respekton UÇK-në. Eshtë interesante qysh kjo fushatë nuk nisi kur znj. Gërvalla erdhi në listën tonë zgjedhore e as kur u emërua ministre, por tash që u kthyte nga vizita e suksesshme në Bruksel. Znj. Gërvalla e mbron dhe e afiron luftën tonë Çlirimtare dhe UÇK-në. Në takimet me ndërkombëtarë ajo e shpjegon agresionin dhe krimet e Serbisë gjatë luftës në Kosovë si pakkush tjetër", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet

në "Facebook". Kjo ka nxitur reagime të shumta të opozitës, duke thënë se Kurti duhet ta mbrojë UÇK-në e jo ministren Gërvalla. Sipas tyre, kryeministri Kurti ka nisur luftën speciale të propagandës. Partia Demokratike e Kosovës ka insistuar në qëndrimin e saj se Gërvalla nuk duhet të qëndrojë më ministre e Jashtme. Deputetja e kësaj partie, Blerta Deliu-Kodra, ka akuzuar ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, se është duke e sulmuar UÇK-në me narrativë

të Serbisë. "Një zyrtare e lartë shtetërore që në Këshillin e Sigurimit mbështet publikisht shpifjen serbe se Gjermania ka kryer gjenocid ndaj serbëve dhe në arenën ndërkombëtare përhap propagandën serbe se UÇK-ja në radhë të parë ka bërë krimë ndaj shqiptarëve duke 'argumentuar' narrativen e Serbisë për UÇK-në si një organizatë terroriste, dihet mirëfilli se çfarë interesash përfaqëson, me apo pa vetëdije", ka shkruar ajo në profilin e vet në "Facebook".

Më e ashpër në reagim ka qenë Partia Socialdemokrate (PSD), e cila të mërkurën ka realizuar një aksion simbolik para Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ku në veturën zyrtare të ministres Donika Gërvalla ka shkruar mbishkrimin "UÇK". Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka akuzuar kryeministrin Albin Kurti se ka nisur luftën speciale të propagandës ndaj UÇK-së.

"Kosova nuk mund të ketë suksese në diplomaci nëse është e shpërfytyruar nga brenda. Kosova nuk ka ku shkon pa UÇK-në. Kurti pati thënë se nuk e pranon Gjykatën dhe nuk i dorëzon njerëzit. Pastaj tha se shteti duhet ta organizojë mbrojtjen. Tash ka nisur luftën speciale të propagandës. Në emër të transparencës qeveria e ka dëmtuar mbrojtjen duke deklasifikuar pagesat për avokatët. Sikur në luftë, edhe sot e njëjtë këngë. Po na tregojnë sa kushton UÇK-ja. Janë shumë veshë që duan ta bëjnë kalkulimin dhe koston argument. Ky regjistër është i njëjtë që para luftës na i tregonte pasojat dhe rreziqet e luftës. Këtij veshi po i fryr Kurti sot. Kalkulimi është argument i frikës, i reaksionit. UÇK-ja është e guximit, e historisë", ka shkruar Molliqaj në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall

Sherifi, në një konferencë për media, ia ka rikujtuar kryeministrin Albin Kurti deklaratat sa ishte në opozitë në lidhje me UÇK-në dhe Gjykatën Speciale. Sherifi e ka pyetur Kurtin për heshtjen gjatë procesit kur Gjykata Speciale duhej të vendoste lidhur me kërkesën e avokatëve për mbrojtjen në liri të ish-krerëve të UÇK-së. "Fatkeqësisht që nga ardhja në pushtet pas zgjedhjeve të 14 shkurtit, Albin Kurti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që të mund të konstatonim se ai ka për preokupim mbrojtjen e UÇK-së në arenën ndërkombëtare e në Gjykatën Speciale. Ai nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në këtë drejtim edhe pse në cilësi të opozitarit deklaronte se mbrojta e UÇK-së është edhe punë qeverie, sidomos punë qeverie! Prandaj, ftojmë kryeministrin Albin Kurti që t'i japë fund

logjikës së veprimeve me dy kute, kur ndryshe fliste sa ishte në opozitë dhe krejt ndryshe është duke vepruar që nga ardhja në pushtet! Koha është që të bëjë saktësisht atë që kërkonte nga të tjerët sa ishte në opozitë!", ka thënë Sherifi. Kurse drejtori ekzekutiv i KMDLNj-së, Behxhet Shala, ka bërë me dije se Kosova nuk mund të ofrojë garanci për ish-udhëheqësit e UÇK-së. "Presidencia dhe kryeministri i Kosovës nuk mund të jepin garanci për ata që janë në Hagë. Askush nuk mund të jepë një garanci të tillë, sepse askush prej tyre nuk ka kërkuar garanci", ka thënë Shala. Të mërkurën edhe presidencia dhe qeveria kanë bërë me dije se nuk të janë garantues për lirim me kusht të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët po akuzohen për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit nga Gjykata Speciale në Hagë.

Këshilltari i presidentes Vjosa Osmani, Bekim Kupina, ka thënë se gjyqtari i Dhomave të

Kosova s'mund ta garantojë mbrojtjen në liri të krerëve të UÇK-së

Drejtori ekzekutiv i KMDLNj-së, Behxhet Shala, ka bërë me dije se Kosova nuk mund të ofrojë garanci për ish-udhëheqësit e UÇK-së. "Presidencia dhe kryeministri i Kosovës nuk mund të jepin garanci për ata që janë në Hagë. Askush nuk mund të jepë një garanci të tillë, sepse askush prej tyre nuk ka kërkuar garanci", ka thënë Shala. Të mërkurën edhe presidencia dhe qeveria kanë bërë me dije se nuk të janë garantues për lirim me kusht të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët po akuzohen për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit nga Gjykata Speciale në Hagë.

Specializuara ka përmendur një shtet të tretë dhe se Kosova në asnjë interpretim nuk mund të konsiderohet shtet i tretë. "Çështja e garancisë është përmendur në mendimin e ndarë të njërit prej gjyqtarëve (Kai Ambos), por nuk është pranuar si opsjon nga Paneli i Apelit të Dhomave të Specializuara. Për më tepër, në mendimin e ndarë, gjyqtari Kai Ambos qartë i referohet shtetit të tretë. Republika e Kosovës me asnjë interpretim nuk mund të konsiderohet shtet i tretë sepse gjykata funksionon nën juridikcionin e Republikës së Kosovës. E njëjtë është themeluar nga vetë Kuvendi i Kosovës si dhe vepron në përpunthje me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës", ka thënë Kupina për "T7". Të njëjtën gjë e ka thënë edhe zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu. "Bazuar në

dispozitat ligjore, garancia nuk kërkon as nga shteti amë (Kosova) e as nga kryeministri i shtetit amë (Qeveria e Republikës së Kosovës), nga i cili vjen i akuzuar dhe të cilit shtet i takon Gjykata Speciale me juridikcion. Pra, Kosova nuk mund të shërbëjë si garantues ashtu siç po raportohet", ka deklaruar Kryeziu për "Radion Evropa e Lirë".

Zëvendëskryeministra dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, para disa vitesh kishte thënë se sapo të formohet Gjykata Speciale do ta ndihmonte atë me materiale kundër, siç thoshte ajo, "kokave të organizatës kriminale: Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit".

Gërvalla kriminel e kishte vlerësuar edhe Rexhep Selimin që është pjesë e Lëvizjes Vetëvendosje.

Millanoviqi: Nuk mund të ofroj garanci për Thaçin



Prishtinë, 5 maj - Presidenti i Kroacisë, Zoran Millanoviq, ka demantuar shkrimet e mediave në Serbi, se kinse ai i ka ofruar garanci Hagës për t'ia mundësuar ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçit, që të mbrohet në liri.

Thaçit po akuzohet për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit nga Dhomat e Specializuar dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar. "Kjo është e pamundur, nuk mund të jep garanci të tillë

sepse kjo nuk është kompetencë e imja", ka thënë ai duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve gjatë vizitës në qytetin kroat, Sisak. Ai ka përkujtuar që pas ngritjes së akuzës kundër Thaçit, kishte deklaruar se për atë aktakuzë mendon "gjithçka të keqe". Ai ka vlerësuar që aktakuza kundër Thaçit është mënyrë për ta dështuar rajonin. "Tani dikush në çarshinë e Beogradit ndoshta do të ma zë për të madhe, por unë nuk jam

armik i serbëve, as kam qenë, as nuk do të jem kurrë. Thjesht, mendoj se është e dëmshme. Thaçi është dashur të ishte akuzuar ose të ishte lënë i qetë, sepse disa njerëz nga Beograd kalojnë lehtë (të paprekur)", tha Millanoviq. Ai është i bindur se Thaçi ka të ngjarë të arrrijë pleqérinë para gjykatës për shkak të akuzave "të paprovuara" në reportin e Këshillit të Evropës lidhur me pretendimin për trafikim të organeve. "Në këtë kuptim,

konsideroj se kjo është dëmtuese, por nuk kam ofruar kurrrarë garancish dhe as që mund ta bëj këtë. Kjo, thjesht, është e pamundur. Edhe po të kisha thënë kështu, unë e kam të pamundur ta bëj këtë", ka thënë Millanoviq. Ai ka shtuar që Kroacia nuk do ta bënte atë që e ka bërë Hungaria si anëtarë e BE-së - që t'i japë azil ish-kryeministrin maqedonas, Nikola Gruevski, i cili kishte ikur në Hungari, në mënyrë që t'i shmangej

dënimit me burg prej dy vjetësh për shkak të korruptionit. Gjykata Speciale e Hagës për hetimin e krimeve të kryera gjatë luftës së Kosovës në titor të vitit të kaluar konfirmoi aktakuzën ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, nën dyshime për kryerjen e krimeve të luftës në Kosovë më 1998 dhe 1999. Të gjithë ata janë në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit të kaluar.

"Duart e Bamirësisë" dhuroi 100 pako ushqimore për familjet në nevojë

MALISHEVË, 5 MAJ (ER) - Në muajin e shenjtë të Ramazanit dhe në prag të festës së Bajramit të Madh, Shoqata Bamirëse "Duart e Bamirësisë" të mërkurën i ka dhuruar 100 pako ushqimore për familjet në nevojë në

Komunën e Malishevës, të cilat do të shpërndahen gjatë ditëve në vijim, në prag të festës së Bajramit.

Ndihmat i kanë pranuar nënkyretari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha dhe drejtori i Drejtorisë për

Mbrojtje dhe Shpëtim, Hafir Rexha. Me këtë rast, nënkyretari Berisha e ka falenderuar shoqatën "Duart e Bamirësisë" për këtë donacion në pako ushqimore për familjet në nevojë.



Bahtiri e njofton shefin e OSBE-së me situatën e përgjithshme në Mitrovicë

MITROVICË, 5 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, i shoqëruar nga nënkyretari Faruk Mujka, ka pritur të mërkurën në takim shefin e ri të misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, Michael Davenport, me të cilin kanë biseduar lidhur me bashkëpunimin dhe kontributin e deritanishëm që misioni i OSBE-së ka ofruar për Komunën e Mitrovicës.

Fillimisht kryetari Bahtiri i ka shprehur mirëseardhje Davenport dhe e ka uruar me rastin e marrjes së detyrës së re të shefit të misionit të OSBE-së për Kosovë, duke thënë se Komuna e Mitrovicës është mirënjohëse ndaj OSBE-së, të cilët në vazhdimësi kanë ofruar ndihmën dhe mbështetjen e

nevojshme në drejtim të mbrojtjes, promovimit dhe përmirësimit të respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë.

Bahtiri ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim edhe me shefin e ri të OSBE-së për Kosovë me qëllim të realizimit të projekteve të përbashkëta. Ai e ka njoftuar Davenport për situatën politike dhe zhvillimet aktuale në Mitrovicë dhe vend. Ndërsa shefi i misionit të OSBE-së për Kosovë, Michael Davenport, ka falenderuar kryetarin Bahtiri për realizimin e këtij takimi, duke thënë se ky takim do të shërbejë si vazhdimësi e përpjekjeve, në kontekst të ndërmarrjes së veprimeve të përbashkëta për të mirën e qytetarëve të vendit dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.



Më 11 maj fillojnë dëgjimet publike në Prizren për kornizën afatmesme buxhetore


PRIZREN, 5 MAJ (ER) - Komuna e Prizrenit do të organizojë katër dëgjime publike lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024, ku do të merren propozimet dhe kërkesat e qytetarëve lidhur me projektet dhe shërbimet komunale.

Në këto dëgjime, që do të mbahen në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, ftohen përfaqësuesit e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, qytetarët, organizatat ndërkombëtare, përfaqësuesit e OJQ-ve të Komunës së Prizrenit, përfaqësuesit e shoqatave të

bizneseve të Komunës së Prizrenit dhe mediat lokale të Komunës së Prizrenit.

Për shkak të situatës pandemike, pjesëmarrja në këto takime do të jetë e kufizuar sipas distancës dhe hapësirës në sallë, si dhe rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike.

Për të mundësuar sa më shumë pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje, Komuna e Prizrenit këto dëgjime publike do t'i organizojë edhe në formën "online" përmes aplikacionit zoom.



Për Ditën e Dëshmorëve, aksion vullnetar për dhurimin e gjakut në Podujevë

PODUJEVË, 5 MAJ (ER) - Përnder të Ditës së Dëshmorëve në Komunën e Podujevës, u organizua aksion për dhurimin e gjakut në sheshin "Ali Ajeti". Këtij aksioni iu bashkuan anëtarë të ekzekutivit komunal, asamblistë të kuvendit

komunal, familjarë të dëshmorëve dhe qytetarë të Komunës së Podujevës. Në prononcimin para mediave kryetari Bulliqi ka thënë se i mirëpret dhe i mbështet aksionet e tillë që kanë qëllim humanitar, po ashtu kryetari Bulliqi ka treguar arsyen e

organizimit të këtij aksioni që po bëhet përnder të Ditës së Dëshmorëve, ku vlerësoi lart sakrificën e dëshmorëve përlirinë e vendit dhe shtoi se Llapi në çdo periudhë ka dëshmuar dashurinë dhe përkushtimin ndaj atdheut.



Ka filluar mësimi plotësues për nxënësit që kanë ngecje në arritjen e rezultateve

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRIŠTINË, 5 MAJ - Bazuar në vendimin e datës 20 prill 2021 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MAShTI), të mëkurën ka filluar mësimi plotësues për nxënësit që kanë ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë e pandemisë Covid-19.

Shumica e drejtorive komunale të arsimit i kanë dërguar në MAShTI raportet e tyre të cilat konfirmojnë se ky proces ka nisur ashtu siç është paraparë. Drejtori Komunal të Arsimit do të raportojnë dy herë brenda muajit përmbarëvajtjen e

mësimit plotësues.

Mësimi plotësues për nxënësit që kanë ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë e pandemisë Covid-19 po organizohet në të mirë të këtyre fëmijëve.

Prioritet i MAShTI-t mbetet përmirësimi i rezultateve dhe dëmeve të shkaktuara nga pandemia.

MAShTI do të jetë në mbështetje të mësimdhënësve dhe nxënësve që ky proces të ketë sukses.

Mësimi plotësues po organizohet në objekte shkollore dhe do të vazhdojë deri në përfundim të vitit shkollor 2020-2021.



Katër viktima dhe 153 raste të reja me Covid në Kosovë

PRIŠTINË, 5 MAJ (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar të mëkurën se ka regjistruar katër viktima nga koronavirusi dhe 153 raste të reja pozitive. Rastet e të vdekurve u regjistruan në komunat: Gjakovë, Mitrovicë, Prizren dhe Viti, ndërsa rastet e reja pozitive rezultuan pas testimit të 1 474 mostrave.

Shifra prej 153 i bie që 10 për qind e të testuarve kanë dalë pozitivë. IKShPK-ja, po ashtu, njoftoi se në 24-orëshin paraprak, 310 pacientë janë shëruar nga koronavirusi. Me këto shifra, numri i përgjithshëm i të infektuarve në Kosovë shkon në 105 864, i viktimateve në 2 195 dhe i të shëruarve në 96 322. Aktualisht raste aktive janë 7 347.

Haradinaj në Deçan nderon luftëtarët e Brigadës 131 'Jusuf Gërvalla'

DEÇAN, 5 MAJ (ER) - Me rastin e 5 Majit, Ditës së Dëshmorëve të Kombit Shqiptar, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka bërë homazhe të mëkurën në Deçan, duke nderuar luftëtarët e Brigadës 131 "Jusuf Gërvalla". "Gjithashtu nderuam të gjithë të rënët përliri dhe dinjitet kombëtar në të gjitha trevat tona, në periudha të ndryshme historike. Heroizmi dhe

sakrifica e dëshmorëve të kombit do të jetë përherë udhërrëfyes në rrugën tonë të shtetndërtimit dhe të bërges së faktorit shqiptar në rajon, faktor i vërtetë i paqes, stabilitetit dhe zhvillimit. Është obligim yni i përbashkët të kujtojmë e nderojmë veprën, guximin e sakrificën e përpjekjeve tona historike përliri", ka thënë Haradinaj.



Ahmeti pret në takim kryetarin e Athinës, diskutuan për bashkëpunimin e dyanshëm

Prishtinë, 5 maj (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka pritur të mëkurën në takim kryetarin e Athinës, Kostas Bakoyannis. Ahmeti ka bërë me dije se së bashku me

Bakoyannis diskutuan për reformat në Prishtinë dhe Athinë, përfshirë sfidat përgjatë përbaljes me pandeminë, si dhe përtëma të tjera me interes përliri palët. "Jam shumë i

lumtur për bashkëpunimin që do të ndërtojmë tutje në shumë fusha, e sidomos për shkëmbimin e traditave dhe kulturës", ka thënë Ahmeti pas takimit.



Auditori kritikon institucionet, Rizvanolli: Qeveria në agjendë e ka Ligjin për nënshkrimin elektronik



Kryetarja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Hykmete Bajrami, ka thënë se, sipas auditimit, institucionet e vendit nuk kanë arritur të sigurojnë qeverisje të mirë të teknologjisë së informacionit

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 5 MAJ - Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar të mërkurën raportin "Organizimi dhe menaxhimi i investimeve të teknologjisë së informacionit që ka të bëjë me të gjitha institucionet publike".

Kryesuesja e këtij komisioni, Hykmete Bajrami, ka thënë se, sipas auditimit, institucionet e vendit nuk kanë arritur të sigurojnë qeverisje të mirë të teknologjisë së informacionit. Bajrami ka përmendur që në këtë kohë do të ishte i

nevojshëm edhe Ligji për Nënshkrimin Elektronik. "Auditimi ka nxjerrë në pah që institucionet e Kosovës nuk kanë arritur të sigurojnë qeverisje të mirë të teknologjisë së informacionit dhe nuk kanë pasur një strategji për investime dhe koordinim. Është mirë që të dalat e raportit të merren me seriozitet nga institucionet e vendit, përkatësisht nga qeveria, pasi që tash është duke hartuar edhe programin qeverisës", ka thënë Bajrami. Ajo ka folur edhe për shumën e shpenzuar lidhur me softuerët e këtyre aplikacioneve. "Janë investuar

49 milionë dhe është shuma shumë e madhe dhe shumica e softuerëve të këtyre aplikacioneve nuk komunikojmë me njëri-tjetrin, është e nevojshme që të kemi një institucion përgjegjës, kjo do të ndihmonte edhe në reformën e administratës publike", u shpreh ajo.

Kurse ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka deklaruar se me seriozitet do të trajtohen të gjitha të dalat e raportit. Ai ka kërkuar që të procedohet me auditim edhe për periudhën 2019/2020. "Ne e kemi trajtuar këtë raport dhe shumicë e

rekomandimeve do t'i adresojmë me përpikëri. Ne si MPB jemi duke punuar që këtë obligim ta përbushim dhe deri më 7 qershori kemi kohë që të kemi me draftin në qeveri. Kam kërkuar një raport nga Policia mbi hapat që ka marrë, disa pika që flasin për trajtimin e krimit kibernetik. Ka projekte me kosto shumë të lartë. Qëndrimi ynë është se jemi të shqetësuar me të gjeturat e raportit dhe do të kërkojmë llogari pavarësisht që digitalizimi është prioritet, por do t'i ndalim keqpërdorimet", u shpreh ai. Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se duhet

bërë shumë punë për t'i rregulluar të gjitha të gjeturat nga auditori. Rizvanolli ka shtuar se është në agjendën legislative Ligji për Nënshkrimin Elektronik. "Ne si ministri përgjegjëse për hartimin e politikave të teknologjisë kemi shumë punë për të bërë dhe jemi pajtuar me gjetjet e raportit dhe jemi zotuar që do të bëjmë gjithçka, në radhë të parë ofrojmë bashkëpunimin tonë për formimin e trupit koordinues për t'i koordinuar aktivitetet më mirë. Ne jemi pajtuar me gjetje dhe kemi punuar rrëth gjetjes së zgjidhjeve që kanë të bëjnë me ministrin tonë. Është në agjendën legislative përsivjet dhe shume shpejt do ta dërgojmë në parlament që të procedohet ky ligj", u shpreh Rizvanolli.

Kurse drejtori i Agjencisë së Shoqërisë Informative, Kujtim Gashi, ka përmendur disa prej sfidave që i kanë hasur si Agjenci. "Shumë herë kemi pasur sfida për realizimin e objektivave tona. Të gjeturat kanë rezultuar në kosto më të mëdha në fushën e teknologjisë informative. Ne kemi një kronologji të komunikimeve, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit ka dërguar propozim në zyrën e kryeministrit dhe kemi marrë përgjigje negative. Ne kemi menduar që duhet të ekzistojë një strategji e vetme e qeverisjes elektronike dhe nuk ia kemi dalë që ta kalojmë këtë penges", ka thënë ai. Kurse Vlora Spanca nga Zyra e Auditorit ka thënë se 70 përqind e institucioneve kanë mungesë të strategjisë së teknologjisë së informacionit. "70 përqind e institucioneve publike kanë mungesë të strategjisë të politikave të IT-së", u shpreh ajo.

ATK-ja: Tatimpaguesit t'u përgjigjen detyrimeve tatimorea

Prishtinë, 5 maj (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar të gjithë tatimpaguesit se në bazë të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat, kerkohet dokumentimi i origjinës së mallit. Në njoftimin e saj thuhet se aktivitetet e ATK-së në vazhdimësi do të përqendrohen pikërisht te tatimpaguesit të cilët kanë mallra pa origjinë. "Secili

tatimpagues duhet të ofrojë dokumentacionin mbështetës i cili arsyeton prejardhjen e mallit si në vendndodhjen, apo vendndodhjet e tatimpaguesit, ashtu edhe për mallrat në qarkullim jashtë vendndodhjes së tatimpaguesit", thuhet në njoftimin përmes media. Po ashtu, ATK-ja sugjeron që secili tatimpagues t'i dokumentojë të gjitha mallrat nga koha e pranimit (qoftë

përmes importimit, blerjes, shkëmbimit apo mënyrave të tjera) derisa ato të janë shitura apo ndryshtë të janë sistemuar, përfshirë dokumentacionin e shitjes apo sistemim tjeter. ATK-ja inkurajon të gjithë tatimpaguesit që t'u përgjigjen në mënyrë të saktë detyrimeve tatimore, në të kundërtën ATK-ja do të detyrohet që t'i ndërmarrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor.



Odat ekonomike kërkojnë ndryshimin e Ligjit për Festat Zyrtare



Oda e Afarizmit e Kosovës dhe Oda Ekonomike e Kosovës kanë kërkuar urgjentisht të bëhet plotësim ndryshimi i Ligjit për Festat Zyrtare meqenëse, sipas këtyre odave, ditët e shumta të pushimit dhe lidhja e tyre me ditët e fundjavës janë duke e dëmtuar zhvillimin ekonomik të Kosovës

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 MAJ - Përfaqësuesit e Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) dhe Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) kanë kërkuar nga Qeveria e Kosovës të propozojë ndryshim plotësimin e Ligjit për Festat Zyrtare. Sipas një reagimi për media të OAK-ut, praktika e deritanishme për pushimet po e dëmon ton zhvillimin ekonomik. "Praktika e deritanishme, që ditët e festave që bien në ditë vikendi të

zëvendësohen me pushim gjatë ditëve të punës, përkatësisht nen 4 i Ligjit për Festat Zyrtare, sipas të cilës, 'kur ditët e festave zyrtare të cekura në nenin 2 të këtij ligji bien ditën e shtunë ose të diel, ditë pushimi do të janë ditët pasardhëse të punës', është praktikë e cila ka dëmtuar dhe po e dëmon ton vendin jo vetëm në aspektin financiar, por edhe në aspektin e reputacionit ndërkombëtar, sepse asnje vend tjetër nuk e zëvendëson pushimin në një datë tjetër. Rastet sikur po ndodhin

aktualisht, që pushimi i 1 Majit (ditë e shtunë) dhe Krishtlindjet ortodokse (ditë e diel), të zëvendësohen në ditën e hënë dhe të martë, janë raste të palogjikshme dhe po e dëmtojnë ekonominë dhe buxhetin e shtetit", thuhet në reagim. OAK-u kërkon që ditë pushimi të jetë vetëm dita e cila bie festa dhe të mos zëvendësohen me ditët vijuese. Gjithashtu, OAK-u kërkon që të festohen, por të mos janë ditë pushimi: 9 prilli - Dita e Kushtetutës dhe 9 maji - Dita e Evropës.

Në fund OAK-u kërkon që festat për nder të komuniteteve të janë ditë pushimi për këto kategori, por jo edhe për gjithë vendin. Edhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka reaguar lidhur me pushimet zyrtare. Rukiqi me anë të një shkrimi në profilin e vet në "Facebook" ka kërkuar që Ligji për Festat Zyrtare të ndryshojë sa më shpejt që është e mundur. "Uroj që 'vikendi' i porsapërfunduar të jetë alarmi i fundit për çoroditjen që e

kemi në kalendarin e festave zyrtare. Ligji për Festat Zyrtare duhet të ndryshojë sa më shpejt që është i mundur. Nuk ka kuptim që brenda vitit të humben mbi 10 ditë pune, vetëm pse një festë zyrtare, qëllon të jetë në fundjavë", ka shkruar Rukiqi. Sipas këtij ligji, në Kosovë janë njëmbëdhjetë festa zyrtare.

Festat zyrtare në Kosovë, të përcaktuara me ligj, janë Viti i Ri, Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Dita Ndërkombëtare e Punës, Bajrami i Madh, Bajrami i Vogël, Krishtlindjet Katolike, Krishtlindjet Ortodokse, Pashkët Katolike, si dhe Pashkët Ortodokse. Madje Kosova feston edhe 9 Majin - Ditën e Evropës, e që është ditë pune për qytetarët e vendeve të BE-së. Përveç këtyre festave, në Kosovë, sipas ligjit, janë të përcaktuara edhe tetë ditë të tjera memoriale. Data 28 nëntor shënohet si Dita e Flamurit të shqiptarëve dhe 12 Qershori - Dita e Paqes, e që për të dy ditët pushohet, kurse gjashtë festat tjera e memoriale i përkasin Dites së Komuniteteve të ndryshme që jetojnë në Kosovë.

Kosova, burimi kryesor i turistëve në Shqipëri

PRISHTINË, 5 MAJ - Sezoni turistik këtë verë në Shqipëri pritet të shënojë rritje krahasuar me vitin e kaluar, kur kufizimet dhe situata e pandemisë Covid-19 ishte më e rënduar. Por, pavarësisht prej lehtësirave që pritet të aplikohen këtë sezoni, sërisht operatorët turistikë janë skeptikë për ardhjen e turistëve nga Evropa.

Sipas të dhënave, më së shumti turistë që pritet të vijnë sivjet në jug të Shqipërisë do të janë kryesisht shqiptarët e rajonit ato të Kosovës, maqedonas dhe nëse do të rihipen vende si Polonia dhe Çekia, që kanë masa izolimi për shkak të situatës nga Covid-19.

Ndryshe, sfida e operatorëve shqiptarë këtë sezoni do të jetë konkurrenca me homologët e tyre në Mal të Zi, të cilët kanë filluar bum rezervimesh për shkak të uljes së çmimeve. Aktualisht, i gjithë personeli i operatorëve turistikë të vendit është në proces vaksinimi kundër Covid-19, në mënyrë që të kemi një sezoni sa më të qetë dhe të sigurt për pushuesit.



Deklaratat skandaloze të ministres së Punëve të Jashtme dhe pasojat diplomatike e juridike për Kosovën!



Shkruan: Dr. sc. Ferat SHALA, deputet i Kuvendit të Kosovës

Që nga koha e emërimit në postin e ministres së Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Donika Gërvalla-Schwarz, ka bërë një varg deklaratash skandaloze që bien ndesh me qëndrimet e shtetit Kosovës dhe me interesat e saj dhe që rrjedhimisht sjellin pasojat diplomatike dhe juridike përvendin.

Ti rikujtojmë edhe një herë disa nga këto deklarata dhe të radhisim disa argumente për pasojat që ato sjellin.

1. Në takimin e fundit të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara ajo tha:

“Ne jemi të interesuar për një dialog të hapur për të kaluarën tonë të përbashkët dhe shpresojmë edhe për të ardhmen tonë të përbashkët”.

Kjo deklaratë është një gabim historik dhe një mungesë totale e sensit diplomatik. Kosova kurrë nuk ka pasur të kaluar të përbashkët me Serbinë dhe as që ka qenë pjesë e saj, por e Jugosllavise. Për 100 vjet me radhë ajo ka qenë e okupuar nga Serbia. Ky është fakt dhe nuk e ndryshon dhe interpreton ndryshtë askush e as zonja Gërvalla.

2. Deklaratat e saj të vazhdueshme kundër përfaqësuesve të UÇK-së janë ndërhyrje në drejtësinë dhe janë pozicionim i quartë në anën e atyre që dëshirojnë ta errësojnë luftën e madhe çlirimtare dhe historinë e saj të ndritshme.

3. Deklaratat e saj, se do të angazhohet personalisht kundër pjesëtarëve të UÇK-së, janë në kundërshtim me pozicionin shtetëror të Kosovës.

4. Deklaratat dhe qëndrimet e saj

të vazhdueshme dëmtojnë jo vetëm pozicionin e mbrojtjes së të akuzuarve në Hagë, por e vështirësojnë edhe mbrojtjen e tyre në liri.

5. Deklaratat dhe qëndrimet e saj kanë bërë që ajo të vet ofrohet si dëshmitare vullnetare kundër të akuzuarve në Hage dhe kundër liderëve të UÇK-së.

6. Askush nuk ia ndalon asaj që të merret me mbrojtjen e të drejtave njeriut dhe me çështje humanitare si individë apo si përfaqësues i ndonjë organizata joqeveritare, por kjo nuk i lejohet nga pozita të cilën e mban aktualisht.

7. Nga pozita e një qytetare të lirë ajo mund të bëjë deklaratën dhe të deponojë dëshmi kur të dëshirojë dhe nuk do të gjykoj ashtu sikurse po gjykohet tani.

8. Është e palogjikshme që ajo të japë deklaratën dhe të ketë informata personale përkrimet e kryera në Kosovë, edhe pse nuk ka jetuar asnjëherë këtu, e të mos ketë informata përvrasjen e babait të saj në Gjermani, ku ajo jeton që 30 vjet.

9. Mund të tolerohen deklaratat e saj përcarëse dhe në dëm të imazhit të Kosovës që i ka bërë tash dy dekada me radhë si individ dhe si anëtare e një partie politike, por nuk mund të tolerohen deklaratat e saj dhe dëmi që po i bën shtetit të Kosovës nga pozita e ministres së Jashtme dhe udhëheqëses së diplomacisë shtetërore.

10. Në komunikime ndërkontaktore dhe sipas interpretimeve të së drejtës ndërkontaktore deklaratat e presidentit, kryeministrit dhe të ministrit të Jashtëm janë qëndrime zyrtare të një shteti dhe në këtë rast deklaratat e ministres së Jashtme konsiderohen si qëndrime zyrtare të Republikës së Kosovës.

11. Deklaratat publike dhe zyrtare të saj mund të përdoren nga kundërshtarët e shtetësisë së Kosovës dhe në mënyrë të veçantë nga Beograd dhe Moskë për të lobuar kundër pranimit të shtetit të Kosovës në institucionë dhe organizata ndërkontaktore.

12. Deklaratat dhe qëndrimet e

një ministri të punëve të Jashtme janë obliguese edhe për ambasadorët dhe diplomatët e atij vendi. Në rastin e Kosovës, përfaqësuesit tanë diplomatikë do të duhej që t'i bashkohen asaj që të shajnë dhe denigrojnë përfaqësuesit e UÇK-së dhe të lojbojnë kundër mbrojtjes së tyre në liri.

13. Deklarata e saj si përfaqësuese e Qeverisë së Kosovës për politikë të Jashtme, logjikisht përfaqësojnë edhe qëndrimin e Qeverisë së Kosovës si tërësi, qëndrimin e kryeministrit të vendit, qëndrimin e presidentit të shtetit dhe qëndrimin e Kuvendit të Kosovës.

14. Nëse këto deklaratat do të ishin deklaratat personale dëmi që do t'i shkaktohej vendit do të ishte më i vogël, por deklarimet nga pozita e ministres janë me efekt shumë më të madh diplomatik dhe juridik, prandaj për këtë qëllim ajo do të duhej të shkarkohej nga pozita zyrtare, për ta parandaluar dëmin e pariparueshëm që po i bëhet vendit.

Kujt po i pengon UÇK?



Shkruan: Ismail TASHOLLI

Më 29 janar 2001, në një gazetë të përditshme kishte dalë një titull: “Grafite me përbajtje fye kundër UÇK-së”. Në ato grafite, të shpërndara në muret e një qyteti të Kosovës, shkruante: “Poshtë UÇK-ja”.

Nuk ishin dy vjet të plota që kishte përfunduar lufta dhe dikush mund ta mendonte këtë.

Ka shumë shkaqe që kanë mundur ta krijonin një klimë të tillë, ku disa persona mund ta merrnin guximin e ofendimit të një pjese të qytetarëve që mosnënshtrimin e kishin karakter dhe kauzë, prej atyre psikologjike e deri te ato politike.

Pastaj, erdhi një kohë kur në bisedat e përditshme dikush thoshte se “ata që kanë luftuar vërtet, kanë vdekur”. Ishte fjala për ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Etimologjia e këtij formulimi është në thënien e serbëve për ne: “Një shqiptar i mirë është vetëm një shqiptar i vdekur”. Po ashtu, ka shumë shkaqe pse filluan që qëndrimet raciste për ne t'i “adaptojmë” në diskursin tonë të përditshëm, në cilësimin përveten. E çuditshme, për të mos thënë anomalike, se si erdhëm te një auto-racizëm.

Këto dy raste, e shumë të tjera, janë tregues shqetësues se si ne i kuqojmë, ndërtojmë dhe trajtojmë vlerat tona të përbashkëta, si shoqëri që pretendojmë “perëndimoren”. Sot, udhëheqësit e UÇK-së i kemi në Hagë, si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të shtetit serb për të relativizuar çdo gjë dhe përvrasjet e rishkrue përpjekjet dhe dhimbjen tonë përlarinë e vendit.

Shteti serb ka aktivizuar të gjithë mekanizmat dhe po përdor të gjitha mundësitet, kudo që i ka, përvrasjet e paraqitur luftëtarin e lirisë si dikush që nuk ka qenë.

Çka bëjmë ne? “Qesim petlla në ujë”, nga një pseudodiskurs që idhnakësinë e luftën e ultë politike të brendshme ka busull. Të gjitha institucionet e shtetit, jo vetëm që nuk

ndihmojnë, jo vetëm që heshtin, por tentojnë të pengojnë dhe diskreditojnë udhëheqësit e luftës sonë. Çlirimtare që gjenden në Hagë.

Gabim historik i një klase të papjekur politike

Jo vetëm që po shkatërrojnë dinjitetin e një shoqërie të një konteksti shumë të rëndësishëm historik, e që është universal (lufta përliri),

por po e mbjellin edhe farën e mosmirënjohjes. Farën më të poshtë për t'ju kundërvënë njëri-tjetrit.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës bëri historinë, ktheu dinjitetin përmes shembullit të mosnënshtrimit dhe hapi udhë të rëndësishme përvrasjet e krenarinë shoqëria janë.

Deri më sot UÇK i ka penguar vetëm Serbisë, sepse ia ka prishur illogaritë e planit të saj fashist përvrasjet e Ballkanin.

Kush nga ne po i bëhet sot armik UÇK-së dhe cila është

nevoja e këtyre politikanëve për një “performansë” kundër Çlirimtarëve?

Sa i marrë duhet të jetë njeriu që të mos dijë ta ndajë një vlerë të shenjtë të popullit tonë me luftën e përditshme politike?

Politika janë është bërë “skenë ku defilojnë vetëm sedra të lënduara”. Përtej, kësaj nuk kanë shikim dhe mbi këtë po ndërtojnë verbërinë e tyre politike.

Perëndia ua ndriçoftë rrugën. Amin!





KOMPANIJA REGIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

K.R.M. "ÇABRATI"

Tel.+381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabradi.com
e-mail. info@cabradi.com
Gjakovë - Gjakova

KOMPANIJA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligi Nr. 03L/212), nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.7/2017, dhe Vendimin Nr.49/2021 me Nr. Protokoli 759 i datës 05.05.2021, në përputhje edhe me Organogram dhe Rregulloren "Për Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Përgjegjësitë në Punë", Nenit 5 të "Rregullores Për Pagat" si dhe kompetencave të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrje Publike në fuqi, nenit 25 të Statutit të K.R.M. "Çabradi" Sh.A, Gjakovë, Kryeshefi Ekzekutiv me datë 06.04.2021, vendos të shpallë:

KONKURS

Pozita: Kontroll e Brendshme-Kontrollor

Numri: 1 /një/

Kohëzgjatja: Kohë të caktuar

I përgjigjet: Koordinatorit për Faturim dhe Inkasim dhe Menaxherit të Operativës.

Vendi: Gjakovë.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Siguron kualitetin e shërbimit dhe korrektsinë e punëtorëve duke monitoruar gjithë aktivitetet e njësisë konform me planet e sektorit;
- Implementon kontrollin ditor bazuar në detyrat e caktuara nga udhëheqësi;
- Identifikon parregullsitë dhe merr masat e nevojshme për mënjanimin e tyre;
- Të hartojë dhe zbatojë strategjinë/ planin e kontrollimit;
- Të zbatojë metodat e avancuara të detektimit të keqpërdorimeve eventuale dhe të denoncon me shkrim dhe në mënyrë profesionale, qdo keqpërdorim apo parregullsi që dëmontruan interesin dhe imazhin e Ndërmarrjes;
- Të mbajë ditarin e punës në të cilin evidenton, inspektimet, vërejtjet dhe veprimet e ndërmarrja dhe të bënë përpunimin analistik të dhënavëve, të cilat mund të shërbejnë si dëshmi materiale në raste të keqpërdorimeve eventuale;
- Dorëzimi dhe zhvillimi i raporteve lidhur me çështjet e kontrollës;
- Çdo detyrë në lidhje me terren, pika të zeza dhe inspektim te hedhjeve te mbeturinave bëhet nën monitorimin e Menaxherit Operativ;
- Përbush detyra tjera nga fusha e tij/saj e përgjegjësisë sipas kërkesave të Udhëheqësit;

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuar:

Kushtet e përgjithshme:

- Të ketë të kryer shkollën e mesme;
- Të ketë së paku një (1) vit përvojë pune;

Kushtet e veçanta:

- Njohja e punës me kompjuter,
- Aftësi të mira organizative,
- Të mos jetë i/e dënuar ose nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj).

Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin,
- CV-në,
- Dëshminë e shkollimit,
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Dëshmja se e njeh punën me kompjuter,
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj),
- Kopja e dokumentit të identifikimit.

Konkursi është i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga data 06.05.2021 deri me datën 20.05.2021, në orën 16:00.

Kërkesa me dokumentacionin e kërkuar, kandidatet duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM."Çabradi" Sh.A. në Gjakovë, Rr."Mazllom Lakuci" pn. (tek menaxheri i Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë. Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatet i nënshtronen procedurës së testit dhe intervistës.



TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE

Bilanci i gjendjes me : 31.03.2021

Euro'000

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Pasurite		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	8,948.94	6,406.94
Kërkoset ndaj bankave	1,022.24	1,644.71
Bonot e thesarit	-	-
Investimet në letra me vlerë	6,857.82	6,974.45
Kreditë dhe paradhënet ndaj klientëve	56,491.09	58,657.62
Patundshmëritë dhe pajisjet	1,525.82	1,930.36
Pasuritë e paprekshme	278.29	258.26
Pasuritë tatimore të shtyra	38.49	38.49
Pasuritë tjera	283.61	207.77
Gjithsej pasuritë	75,446.29	76,118.61
Detyrimet		
Depozitat e klientëve	58,483.45	58,306.51
Detyrimet ndaj bankave	2,459.66	4,200.59
Fondet tjera të huazuara	4,552.72	3,501.75
Detyrimet tatimore të shtyra	-	-
Detyrimet tjera	1,018.59	992.49
Gjithsej detyrimet	66,514.43	67,001.35
Ekuiteti i aksionarëve		
Kapitali aksionar	10,000.00	10,000.00
Rezervat e kapitalit		
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprak	2,066.71	-
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	990.32	177.82
Perbërsët tjerë të ekuitetit	8.26	7.28
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve	8,931.87	9,117.26
Gjithsej detyrimet dhe ekuite	75,446.29	76,118.61



TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE

Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 31.03.2021

Euro'000

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Të hyrat nga interesit	3,371.07	1,200.51
Shpenzimet e interesit	1,080.46	304.81
Neto të hyrat nga interesit	2,290.61	895.69
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	608.83	124.32
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	145.14	39.33
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet	463.69	84.99
Neto të hyrat nga tregtimi	12.60	-
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	-	0.06
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	1,613.62	445.97
Gjithsej të hyrat	1,153.28	533.48
Provizonet për humbjet nga kreditë	38.85	351.17
Provizonet tjera	-	4.50
Fitimi/(humbja) para tatimit	1,114.43	177.82
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
Shpenzimet e tatimit të shtyer	124.11	-
Fitimi/(humbja) neto	990.32	177.82
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	2.61	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	992.93	177.82



KOMPANIJA REGIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 20.07.2020 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhëshme një vjeqare, KRM"Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 05.05.2021 të Rishpallë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Faturist/e me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësítë:

- Bënë llogaritjen dhe shtypjen e faturave sipas shenimeve dhe çmimeve valide të sektorit të amvisërisë dhe sektorit komersial.
- Mban evidencën mbi ndryshimet dhe specifikacionet nga fushëveprimtaria e punëve dhe detyrave të punës, si dhe dëshminë mbi dorzimin e faturave manipulantve për procedurë të mëtejme (Dergimin e fakturave blerësve),
- Regjistro, udhëheq analitiken e blerësve nga arka në terene (inkasantave) dhe ekstraktek bankare, kryen edhe punë tjera sipas urdhërit të eprorit të drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e këruara:

- Të ketë përgatitje Universitare
- Të prezantoj leternjoftimin
- Cv-në
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetat ditore prej 05.05.2021 deri më datën 20.05.2021. Kërkesat e dorëzuar pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrëtim nga ana e Komisionit Vlerësues.

Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndkimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Al Fix KB Group" Sh.p.k Mamushë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndkimit në Mjedis për Fabrikën për prodhimin e llaqeve në Mamushë, Komuna e Mamushës. Njoftohet publiku i interesuar se më datën 26.05.2021 në ora 10:00 në Restaurant "Ergul Kafe", Rr. Cumuriyet, Mamushë do të organizohet debat publik nga Kompania "Al Fix KB Group" Sh.p.k Mamushë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndkimit në Mjedis për Fabrikën për prodhimin e llaqeve në Mamushë, Komuna e Mamushës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku:

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vcxkadVorQT09>


Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Al Fix KB Group" Sh.p.k Mamushë për Fabrikën për prodhimin e llaqeve në Mamushë, Komuna e Mamushës.

https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publikimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Kushtrim Elshani shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Lekë Dukagjini " Prizren.
- Fitore Qatani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlle " Ymer Prizreni " Prizren.
- Berat Gashi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlle " Ymer Prizreni " Prizren.
- Hasan Maloku shpall të pavlefshme diplomën shmlle "11 Marsi " Prizren.
- Jap banesë me qira afér 60 m², katë III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplekt, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë përpërkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhamet Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, katë dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhamet Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përboll "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², katë dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpijan katë i parë, posedon tre shtretër dhe i mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana katë i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afér AAK-së. Banesa është e mobiluar komplekt. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afér "Bill Clintonit", katë tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afér Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplekt, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afér Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershorë deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera ne qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m². Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 044/44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m², dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afér Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Ligenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazeten "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazeten "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazeten "Koha ditore", si bashkpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapercimin e detit", "Sëmundja e endrrave", "Im atë donte Adolfin", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hujave", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.

5.99€

ISBN 978-9951-780-56-8



HËNA PREJ LETRE
•
Mehmet Kraja

Mehmet Kraja



HËNA PREJ LETRE

(Drama, trilogji)



KOMBFORMIMI DHE PËRPJEKJET
E SHQIPTARËVE PËR LIRI DHE BARAZI
një qasje teoriko-interpretuese



Fatmir Lekaj (1971) lindi në Pejë. Që tridhjetë vjet jeton në Norvegji. Fillimi i studiuar për të drejtat e njjerut dhe për trajtimin e konfliktive, ndërkohe edhe për shkencë politike. Ka magjistruar për shkencë politike në Universitetin e Oslo-s, kurse për studime postmagjistraturale është përqendruar në temat që kanë të bëjnë me nacionalizmin, multikulturalizmin dhe integrimin. Merret me veprimtari të kërkuar të pavurur dhe të këshillëdhënies për çështjet e integrimit etj. Është perkthyes i kualifikuar norvegju-shqip dhe sekretar i Rrjetit të Profesionisteve Shqiptare në Norvegji.





The RC Cola logo is displayed at the top left, featuring the words 'ROYAL CROWN' above 'RC' with a registered trademark symbol, and 'cola' below it.

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

Two RC Cola products are shown at the bottom right: a blue can and a dark plastic bottle, both labeled 'RC cola' and 'Columbus, Georgia, USA Since 1905'.